



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS

(prill 2021 – mars 2022)

DHE

PLANI I PUNËS

(prill 2021 – mars 2022)

Prishtinë, prill 2022

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË OSK-SË

Të nderuar kolegë anëtarë të Kuvendit të OSK-së,

Kam nderin të paraqes para juve raportin vjetor të punës për periudhën prill 2021 – mars 2022, që përfshin zhvillimet dhe punën e të gjitha organeve të OSK-së.

Edhe në vitin 2021 jo vetëm vendi ynë u ballafaqua sërish me pandeminë Covid 19 por e tërë bota. Megjithatë, krahas kësaj dhe krahas punës dhe angazhimeve nga detyra e të parit të OSK-së, me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur kemi arritur që gjatë kësaj periudhe njëvjeçare të realizojmë me sukses objektivat e parapara sipas planit të punës të paraparë.

Prandaj, shfrytëzoj rastin që t'ju falenderoj përzemërsisht për angazhim, mbështetje dhe përkrahje të pazezervë dhënë Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Me respekt,

Prof. Dr. Blerim Kamberi

Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës

PËRMBAJTJA

<i>Hyrje</i>	3
<i>Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënia për punën e organeve të Odës</i>	4
<i>Azburnimi në baza mujore i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrin të licencave të stomatologëve</i>	4
<i>Punat e organeve dhe komisioneve të përbërshme të Odës</i>	5
<i>Regjistrimi, licencimi dhe rilicencimi i stomatologëve</i>	5
<i>Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)</i>	7
<i>Çështjet e etike</i>	10
<i>Komisioni për buxhet dhe financa</i>	11
<i>Solidariteti dhe ndihma reciproke</i>	11
<i>Bashkëpunimi ndërkombëtar</i>	11
<i>Memorandumet e bashkëpunimit</i>	13
<i>Bashkëpunimi me odat tjera të profesionistëve shëndetësor</i>	14
<i>Aktivitetet tjera</i>	15
<i>Raporti i pasqyrave financiare</i>	22
<i>Plan veprimi për periudhën prill 2021 – mars 2022</i>	26

HYRJE

Oda e Stomatologëve të Kosovës në përputhje me mandatin e saj ligjor të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutit të OSK-së, si dhe planit vjetor të punës, ka realizuar aktivitetet e planifikuara gjatë periudhës prill 2021 – mars 2022 edhe përkundër vazhdimit të pranisë së pandemisë COVID-19. Raporti në vijim pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara që njëherit kanë qenë të përfshira në planin vjetor të punës së OSK-së.

Në vijim janë paraqitur objektivat të cilat kanë qenë të planifikuara për periudhën prill 2021 – mars 2022.

- Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënja për punën e Odës,
- Asistenca në zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin e kapacitetit të EVP-së dhe në regjistrimin, licencimin/rilicencimin e stomatologëve,
- Azhurnimi në baza mujore i regjstrit të anëtarësisë dhe regjstrit të licencave të stomatologëve si dhe lëshimin e faksimileve unike,
- Nxjerrja dhe Plotësim /ndryshimi i akteve juridike të OSK-së,
- Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK,
- Organizimi i Konferencave stomatologjike,
- Prgatitja e planit dhe programit të ligjeratave profesionale për vitin 2022 në 7 (shtatë) QKMF,
- Mbrojtja e interesave profesionale, konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët e Odës,,
- Organizimi i punëtorive dhe tryezave profesionale qëllim të identifikimit të problemeve, shqetësimeve të komunitetit të stomatologëve si dhe ngritjes së nivelit të tyre profesional,
- Mbështetja financiare për anëtarët e Odës në rastet e sëmundjeve të rënda nga fondi i veçantë i solidaritetit dhe ndihmës reciproke,
- Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme vendore dhe rajonale
- Bashkëpunimi me odat tjera të profesionistëve shëndetësor,
- Vazhdimësia e bashkëpunimit me FDI dhe European Regional Organization (ERO),
- Auditimi financiar dhe funksional për vitin 2020.

1. VAZHDIMËSIA E TRANSPARENÇËS DHE LLOGARIDHËNIA PËR PUNËN E ORGANEVE TË ODËS

Në vazhdimësi është ngritur transparencja dhe llogaridhënia për punën e të gjitha organeve të OSK-nëpërmjet Web-faqes së Odës si mjet për realizimin e këtij objekti. Janë publikuar të gjitha informatat rreth punës së organeve të Odës, vendime dhe çështje tjera relevante të përditësuara në baza të rregullta, që janë me rëndësi për komunitetin e stomatologëve të vendit, e të cilat do të nxisin në vazhdimësi llogaridhënien dhe transparencën e punës së organeve të Odës.

2. AZHURNIMI NË BAZA MUJORE I REGJISTRIT TË ANËTARËSISË DHE REGJISTRIT TË LICENCAVE TË STOMATOLOGËVE

Në baza mujore është bërë përditësimi i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrit të licencave valide të stomatologëve në nivel vendi në Webfaqen zyrtare të Odës.

Deri në ditën e raportimit të punës sonë njëvjeçare, Oda e Stomatologëve të Kosovës numëron 2129 anëtarë të anëtarësuar në odë dhe 2030 stomatolog me licencë valide të punës.

3. PUNA E ORGANEVE DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË ODËS

Kuvendi i OSK-së ka mbajtur dy mbledhje; një mbledhje me votim elektronik, me e-mail, 05 maj-07 maj 2021, me ç'rast është miratuar raporti vjetor i punës së OSK-së për periudhën 01.04.2020 - 31 mars 2021; mbledhja e dytë me prani fizike me 30 tetor 2021 ku janë miratuar: Rregullorja për Revistën e Stomatologëve të Kosovës; Plotësim/ndryshimi i vendimit nr. 1058 të dt 26.12.2019 për caktimin e lartësisë së taksës administrative; Zgjedhja e Dr. Mirlinda Sopi, anëtarie e Gjyqit të nderit dhe zgjedhja e Dr. Donika Bajrami, kryetare e Komisionit për Çështje Etike.

Këshilli Drejtues ka mbajtur 8 (tetë mbledhje) me ç'rast janë marrë disa vendime:

- Mratimi i ndrrimit të lokacionit të selsië së OSK-së;
- Përcaktimi i draftit final të Plotësim/ndryshimi të vendimit nr. 1058 të dt 26.12.2019 për caktimin e lartësisë së taksës administrative për miratim në Kuvend;
- Përcaktimi i draftit final të Rregullores së Revistës së Stomatologëve të Kosovës për miratim në Kuvend;
- Përcaktimi i draft rregullores për Dhënie e dekoratave të OSK-së për miratim në Kuvend;



- Përcaktimi i draft rregullores për marketing në OSK për miratim në Kuvend;
- Miratimi i raporteve financiare sipas periudhave kohore të përcaktuara me Statut dhe rregullore;
- Vendimi për auditim financiar dhe funksional të OSK-së për vitin 2020;
- Miratimi i raporteve të punës së organeve /komisioneve;
- Raporti i punës njëvjeçare i OSK-së (01. Prill -31 mars 2022) për miratim në Kuvend;
- Projekt-buxheti i OSK-së për vitin 2022 për miratim në Kuvend;
- Vendimi për lejimin e mjeteve –participimi i OSK-së për ndërtimin e obelsikut në nderim të profesionistëve shëndetësor;
- Vendimi i lejimit të mjeteve për organizimin e konferencës stomatologjike;
- Vendimi i lejimit të mjeteve për botimin e Revistës së Stomatologëve të Kosovës;
- Emërimi i Këshillit të Ekspertëve Profesional të OSK-së;
- Miratimi i vendimit të Komisionit për solidaritet dhe ndihmë reciproke për lejimin e mjeteve financiare;
- Miratimi i Opinionit të Këshillit të Ekspertëve Profesional mbi arritjen e kompetencës të doktorit të stomatologjisë për dhënien e shërbimeve specifike stomatologjike nga implantologjia dhe ortodoncia në sektroin privat.

4. REGJISTRIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI I STOMATOLOGËVE

Komisioni për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të Stomatologëve ka kryer procedurat ligjore të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit të stomatologëve.

Gjatë periudhës 1 Prill 2021 – 31 Mars 2022 janë:

- a. Anëtarësim **297** stomatolog,
- b. Licencim- Doktor i Stomatologjisë **275** dhe licencim specialistik **62**.
- c. Rilicencim - Doktor i Stomatologjisë **143** dhe Rilicencim specialistik **122**
- d. Të ç'antërasuar (në mënyrë të vullnetshme) **1** stomatolog.
- e. Të fshirë nga regjistri i anëtarësisë janë 13 stomatolog, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore e pagesës së anëtarësisë nëpër vite 2019,2020 dhe 2021.



5. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KVEP) gjatë kësaj peridhe ka akredituar **30 (tridhjetë)** aktivitete në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional, si vijon:

1. Akreditimi i Konferenës “Ortodoncia klinike bashkëkohore”, e Shoqatës së Ortodontëve të Kosovës, e cila u mbajti me datë 15.05.2021, në platformën zoom.

Pjesëmarrja aktive 15 pikë

Pjesëmarrja pasive 10 pikë

1. Akreditimi i Konferenës “Konferenca Kombëtare e Shkencave Mjekësore 8”, e Shoqatës BRAINSTORM e mbajtur me datë 11-13.06.2021, në Tiranë.

Pjesëmarrja aktive 15 pikë

Pjesëmarrja pasive 10 pikë

2. Akreditimi i kursit “Kursi për Implantologji”, e kompanisë Dental Day, i mbajtur me datë 7-8-9 dhe 28-29-30 Tetor 2021, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

3. Akreditimi i Konferenës “Konferencë ndërkombëtare të Shkencave Stomatologjike” e Institucionit të Edukimit të lartë, UBT e mbajtur me datë 29-30 Tetor 2021, në Kampusin e UBT-së – Lipjan.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 6 pikë

4. Akreditimi i Konferenës “Takimin Kombëtar i Shkencave Mjekësore 9”, e Shoqatës BRAINSTORM, e mbajtur me datë 19-21.11.2021, në Tiranë.

Pjesëmarrja aktive 15 pikë

Pjesëmarrja pasive 10 pikë

5. Akreditimi i seminarit “Ligjëratë nga implatonologjia”, e kompanisë Vizion Dent, e mbajtur me 27 Nëntor 2021, në Istog.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

6. Akreditimi i Konferenës “Konferenca e VI-të Stomatologjike-Virtuale”, e Odës së

Stomatologëve të Kosovës, e mbajtur me 18 Dhjetor 2021, në platformën ZOOM.

Pjesëmarrja aktive 15 pikë

Pjesëmarrja pasive 10 pikë

7. Akreditimi i kursit “Veneers dhe roli i tyre në stomatologjinë estetike”, i kompanisë Anka Internacional LLC, i mbajtur me datë 29 Janar 2022, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

8. Akreditimi i kursit teorik-praktik “Urat fikse ne dhembe natyral”, i kompanisë NekiDent, i mbajtur me datë 26-27 Mars 2022, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

9. Akreditimi i Workshopit “Radiografia në implantologji”, i organizuar nga kompania Allianz, që do të mbahet me datë: 16.04.2022, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

10. Akreditimi i Kursit teoriko-praktik “Kurs i Avancuar për Augmentimin Horizontal Kockor”, i organizuar nga kompania Aseps Medical Sh.p.k, që do të mbahet me datë 16.04.2022, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

11. Akreditimi i Kursit “Terapia Ortodontike nga Edgewise ne sistemin dixhital” i organizuar nga kompania Neki Dent, që do të mbahet me datë 16-17.04.2022, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

12. Akreditimi i Kursit “Krijimi i fasetave qeramike sipas qasjes biomimetrike”, i organizuar nga kompania Neki Dent, që do të mbahet me datë: 23-24.04.2022, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë**Pjesëmarrja pasive 8 pikë**

13. Akreditimi i programit të 17 (shtatëmbëdhjetë) ligjëratarave profesionale për vitin 2022 në QKMF (Prishtinë, Gjiilan, Pejë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj dhe Mitrovicë), i organizuar nga Oda e Stomatologëve të Kosovës.

Për ligjëratarat që ligjërohen nga profesorët e QKSUK-së:

Pjesëmarrja aktive 5 pikë**Pjesëmarrja pasive 2 pikë**

Për ligjëratarat që ligjërohen nga stafi i QKMF-së

Pjesëmarrja aktive 3 pikë**Pjesëmarrja pasive 2 pikë**

- Në periudhën raportuese KEVP ka lëshuar 243 Certifikata/vërtetime mbi valorizimin e pikëve kredituese të anëtarëve të saj si dëshmi se plotësojnë kushtet për rilicencimin e tyre, ndërsa 14 raste janë refuzuar për mungesë të pikëve kredituese jot ë mjaftueshme.
- Përpilimi i programit dhe planit dinamik të realizimit të ligjërtave profesionale për vitin 2022 në QKMF nga ana e OSK-së në kuadër të EVP-së

Në bashkëpunim me kordinatorët për EVP, në 7 (shtatë) regionet e Kosovës është përpiluar programi i ligjëratarave profesionale dhe plani dinamik i realizimit të tyre nëpër QKMF-të (Prishtinë, Gjila, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Feriza), për vitin 2022

- **Organizimi i Konferencës stomatologjike nga OSK**

Oda e Stomatologëve të Kosovës ka organizuar Konferencën e VI-të Stomatologjike, e cila është mbajtur në Prishtinë me dt. 18 dhjetor 2021 në hotel Prishtina, me pjesëmarrje fizike të kufizuara për shkak të masave të njohura nga ana e qeverisë së vendit, dhe pjesëmarrja masive nëpërmjet platformës virtuale ZOOM. Konferenca ka përfshirë 11 ligjëratarë me ligjërues vendorë dhe

ndërkombëtarë nga Austria, Turqia, Izraeli, Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia Veriore. Mbi 900 stomatolog kanë marrë pjesë në konferencë.



Pamje nga Konferenca e VI-të Stomatologjike -Virtuale, 18 dhjetor 2021

6. ÇËSHITJET ETIKE

Në periudhën raportuese janë shqyrtuar **tetë raste** për pretendim të shkeljes etike. Një rast është shqyrtuar nga Prokurori, por që nuk është proceduar mëtutje për shkak se ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore (Ligji për Shëndetësi dhe Ligji për OPSH-ve). Në një rast Këshilli Etik ka dhënë një opinion profesional. Një rast Këshilli Etik ka hudhur poshtë pretendimin e inspektoriatit shëndetësor, ndërsa në pesë raste të tjera ka shqiptuar masa disiplinore konform rregullores në fuqi (qortim me shkrim, dhe rekomandim kolegjal)..

Këshilli Etik gjatë kësaj periudhe ka lëshuar **28** vërtetime për të kaluarën etike.

Komisioni Etik në periudhë njëvjeçare, ka shqyrtuar **9** raste për leje të hulumtimit bio-mjekësor, të gjitha kanë qenë të aprovuara nga komisioni.

7. KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA

Gjatë kësaj periudhe kohore njëvjeçare, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur tri mbledhjet e punës. Në kuadër të këtyre tri mbledhjeve, nga Komisioni për Buxhet dhe Financa janë analizuar, shqyrtuar si dhe është bërë aprovimi i raporteve financiare dhe i projekt buxhetit të OSK-së, për periudhat si në vijim:

- 1) Raporti financiar 6 mujor për periudhën: 01.10.2020 – 31.03.2021,
- 2) Raporti financiar 3 mujor për periudhën: 01.04.2021 – 30.06.2021, dhe
- 3) Raporti financiar 6 mujor për periudhën 01.07.2021 - 31.12.2021.
- 3) Miratimi i projekt buxhetit të OSK-së, për vitin 2022

8. SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE

Në Komisionin për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke gjatë periudhës raportuese janë paraqitur dy raste që kanë kërkuar mbështetje financiare për shkaqe shëndetësore. Komisioni i ka shqyrtuar pozitivisht dhe janë lejuar mjetet nga Këshilli Drejtues.

9. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

- **Pjesëmarrja në aktivitetet e FDI**

Në cilësinë e zyrtarit të OSK-së për ndërlidhje me Federatën Ndërkombëtare Stomatologjike (FDI), Dr. Kastriot Meqa ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara në mënyrë virtuale nga organet e FDI, për detyrat që u takojnë anëtarëve të rregullt të kësaj organizate.

- **Takimi me Z. Brane Dobnikar**

Ekspert nga Sllovenia i angazhuar nga LuxDev për të vlerësuar dhe identifikuar nevojat lidhur me ndërtimin e objektit të perbashket për të gjitha odat, gjegjësisht lidhur për një project funksional përfundimtar, projekt i mbështetur nga LuxDev.



- **Vizita e delegacionit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë**

Me dt. 17 mars 2022 në ambientet e Odës, kryetari i OSK-së priti presidentin e Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Dr. Nikoll Deda me bashkëpunëtorë. Takimi u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe shumë miqësor. Të dy homologët shprehëm vullnetin dhe mirëkuptimin për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të domosdoshëm për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës profesionale të stomatologëve nëpërmjet formave të ndryshme të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional. Poashtu u dakordua për të shkëmbyer informacione dhe materiale në ato fusha që janë me interes të përbashkët.



10. MEMORANDUMET E BASHKËPUNIMIT

- Memorandumi i bashkëpunimit me Urdhrin e Stomatologut të Shqipërisë

Në tryezën e punës e organizuar me rastin e shëmit të Ditës Botërore të Shëndetit Oral me datë 18 mars 2022, Kryetari i OSK-së dhe Presidenti i Urdhërit të Stomatologëve të Shqipërisë nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit. Njëkohësisht dakorduan që të inkurajojnë vizitat dhe takimet dypalëshe duke përfshirë ftesa për ngjarjet më të rëndësishme në fushën e stomatologjisë, të bashkëpunojnë për zbatimin e mbikëqyrjes profesionale si dhe në fusha të veçanta të mbrojtjes së interesave dhe reputacionit të ndërsjelltë, të bashkëpunojnë në fushën e publikimeve dhe promovimit të shëndetit oral dhe është tjera me interes reciprok.



- Ripëtrirja e Memorandumit me Institutin për hulumtime dhe trajnime në shkencat mjekësore “Rezonanca”

Me datë 02.02.2022 në ambientet e Kolegjit “Rezonanca” është nënshkruar ripëtrirja e marrëveshjes së bashkëpunimit me Institutin për hulumtime dhe trajnime në shkencat mjekësore “Rezonanca. Marrëveshja parasheh bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve shkencore, promovimin e shëndetit oral, konsulencave profesionale, trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional.



11. BASHKËPUNIMI ME ODAT TJERA TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR

- Kërkesë e përbashkët e OPSH-ve për incrimin e përshejtimit të ri-draftimit të Projektligjit për Pagat e Zyrtarëve publik.
- Shkresa e përbashkët e OPSH-ve drejtuar Ministrit të Shëndetësisë për mbështetje të Projektit “Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët të Odave të Professionistëve Shëndetësor”.

- Realizimi i projektit të përbashkët në ngritjen e monumentit përkujtimor (Obelsikut) në nder dhe përkujtim të kontributit dhe sakrificës së profesionistëve shëndetësor të Republikës së Kosovës, përgjatë dekadave.



12. AKTIVITETET TJERA

- **Takimi me Ministrin e Shëndetësisë Dr. Latifi**

Gjatë takimit kemi adresuar shqetësimet e ndryshme të cilat janë pranuar dhe janë brengë e anëtarëve të OSK-së, si: shqiptimi i gjobave nga ana e Inspektoriatit Shëndetësor për profesionistët shëndetësorë në sektorin privat, mbyllja e ushtrimit të veprimtarisë stomatologjike nga ana e Bordit për licencimin e institucioneve private shëndetësore, vështërsitë në realizimin dhe zhvillimin e programit specialistik në të gjitha fushat e stomatologjisë. Po ashtu kemi ngritur çështjen e stomatologëve nga Lugina e Preshevës që janë të ballafaquar me vështërsitë në marrje të licencës dhe lëshimit të faksimilit. Gjatë këtij takimi kemi ngritur edhe çështjen e papunësisë së stomatologëve në sistemin publik si dhe rishikimi i Udhëzimi Administrativ nr. 08/2017 në mënyrë që edhe specialistët e stomatologjisë të kenë të drejtën ligjore të ushtrojnë profesionin e tyre në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor. Temë tjetër që është biseduar është edhe bartja e kompetencave të përcaktuara

në Ligjin për Shëndetësi dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, me theks të veçantë kompetencat në fushën e edukimit specialistik.

Ministri i Shëndetësisë shprehi gadishmërinë e plotë për një bashkëpunim dhe këshillim profesional me Odën për hartimin e koncept dokumenteve rreth çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me sektorin e stomatologjisë në nivel vendi



- **Takimi me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kemi zhvilluar një takim, në të cilin kanë qenë të ftuar kryetarët e Odave të Profesionistëve Shëndetësor. Tema për të cilën është diskutuar ka qenë: Puna dhe sfidat e Odave të Profesionistëve Shëndetësor, me ç'rast kemi prezentuar një përmbledhje të të arriturave dhe zhvillimit në OSK, por edhe për sfidat e saja si dhe kërkuam mbështetje të komisionit për bartjen e kompetencave ligjore që ende nuk janë bartur nga Ministria e Shëndetësisë.

Komisioni shprehi mbështetjen e punës së deritanishme dhe gatishmërinë për koordinim në të ardhmen.



- **Takim me Inspektoratin Shëndetësor**

Gjatë takimit me Zv. e Detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor Dr. Shaban Osmanaj, janë diskutuar disa nga temat aktuale të sektorit të stomatologjisë me të cilat po ballafaqohet komuniteti ynë në sektorin privat. Jemi zotuar për një bashkëpunim të ngushtë, dhe do t'i ofrojmë njëra tjetrës ekspertizat profesionale në trajtimin e problemeve. Takimet e tilla do të jenë të rregullta me qëllim të intensifikimit të aktiviteteve në funksion të zbatimit të drejtë të legjislacionit të veprimtarisë stomatologjike në Republikën e Kosovës.



- Organizimi i punëtorisë për draftimin e Kodit Etik dhe Deontologjisë Stomatologjike.



- Punëtorja e organizuar mbi arritjen e kompetencës të doktorit të stomatologjisë për dhënien e shërbimeve specifike stomatologjike nga implantologjia dhe ortodoncia



- **Organizimi i tryezës së rrumbullakët nga OSK me temë: Gjendja në sektorin e stomatologjisë: E tashmja dhe e ardhmja”**

Pjesëmarrës të kësaj tryeze ishin delegacioni nga Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë, i kryesuar nga Presidenti Dr. Deda, Shefi i degës së stomatologjisë Prof.Ass.Dr. Dragidella, drejtori i QKSUK-së Dr. Meqa, si dhe përfaqësues të të gjitha niveleve të institucioneve shëndetësore publike, private, Inspektoriatit Shëndetësor, Shoqatës së Stomatologëve të Kosovës, Shoqatës për të drejtat e pacientëve e tj.

Theks të veçantë në këtë tryezë ju dha nevojës mbi hartimin e ligjit për shërbimin shëndetësor stomatologjik, i cili do të përcaktonte rregullat për organizimin dhe funksionimin e shërbimit shëndetësor stomatologjik në Republikën e Kosovës.



- Takimi me grupin e specialistëve në mbështetje të realizimit të kërkesave të tyre që kanë të bëjnë me procesin e edukimit specialistik.



- Pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët me temën *“Të drejtat dhe Siguria e pacientit”* e organizuar nga Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Shkresa Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për planifikim të numrit të studentëve të stomatologjise që pranohen në UP dhe Kolegjet private të arsimit të lartë.
- Pjesëmarrja e përfaqesuesit të OSK-së në komisionin për hartimin e projekt-ligjit për sigurime shëndetësore.
- Opinioni profesional i Keshillit etik lidhur me shkresën e Inspektoriatit Shëndetësor nr. 05-2955 të datës 30/04/2021 lidhur me përmbushjen e kriterit të ofrimit të shërbimit stomatologjik-zbardhja e dhëmbëve në karrikën dhe unitin jostomatologjik.
- Komisioni i veçant profesional i formuar nga OSK, ka dhënë Opinionin profesional për përdorimin e aparaturës për sedacion me bazë gazin oksidul azoti në institucionet shëndetësore, në bazë të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë

13. RAPORTI I PASQYRAVE FINANCIARE

Tabelat me poshtë paraqesin pasqyrimin e të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të Odës, për periudhën 01 prill 2021 – 31.mars 2022. Në kategorinë e të hyrave (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) gjithsejt kanë qenë **176.283.61€**, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) janë shpenzuar gjithsejt **115.049.21 €**. Sipas planit të paraparë është bërë auditimi i jashtëm financiar dhe funksional i OSK-së për vitin 2020.

RAPORT I PËRGJITHSHËM FINANCIAR
PERIUDHA RAPORTUESE: 01.04.2021. – 31.03.2022.

I. TË HYRAT:

1 - NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1-TM4
1.1.	Të hyrat nga anëtarimi	26,100.00€	9,150.00€	9,750.00€	13,850.00€	58,850.00€
1.2.	Të hyrat nga licencimi/rilicencimi	9,700.00€	11,580.00€	18,680.00€	17,660.00€	57,620.00€
1.3.	Të hyrat nga konferenca	30.00€	-	18,975.00€	-	19,005.00€
1.4.	Të hyrat nga EVP	700.00€	300.00€	2,322.00€	3,243.00€	6,565.00€
1.5.	Të hyrat nga Kodi Etik	180.00€	120.00€	330.00€	210.00€	840.00€
1.6.	Të hyrat nga vërtetimet e anëtarisë në OSK	5.00€	5.00€	30.00€	170.00€	210.00€
1.7.	Të hyrat nga taksa për regjistrim dhe valorizim	440.00€	595.00€	855.00€	870.00€	2,760.00€
1.8.	Të hyrat nga mbajtja e provimeve vlerësuese dhe shqiptimi i masave disiplinore	200.00€	400.00€	1,400.00€	840.00€	2,840.00€
1.9.	Të hyrat tjera (duplikim i Licencës, ndërrim i ID, kthime)	140.00€	168.06€	72.75€	45.00€	425.81€
2.0.	Të hyrat nga faksimilat	20,631.00€	1,965.00€	1,195.00€	870.00€	24,661.00€
I. GJITHSEJ të hyrat në llogarinë kryesore:						173,776.81€

2 - NË NËNLLOGARINË BANKARE TË FONDIT PËR SOLIDARITET

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1:TM4
1.1.	Të hyrat nga pagesat e gjobave për Ri-Licencim	85.00€	745.00€	580.00€	675.00€	2,085.00€
1.2.	Deponim i mjeteve të grumbulluara në kutinë e Solidaritet në zyre të OSK	121.80€	-	-	-	121.80€

1.3.	Të hyra nga pagesa e shpenzimeve procedurale të Këshillit Etik të OSK-së	-	-	300.00€	-	300.00€
II. GJITHSEJ të hyrat në nënlogarinë e fondit për solidaritet:						2,506.80€

Gjithsej të hyrat nga: Llogaria kryesore + Llogaria e Solidaritetit (I+II)						176,283.61€

II. SHPENZIMET:

1 - SHPENZIMET NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIM ET TM1-TM4
2.1.	Shpenzimet për paga	10,509.33€	10,073.11€	10,341.09€	11,462.34€	42,385.87€
2.2.	Shpenzimet për mëditje	2,461.88€	1,694.15€	6,274.85€	3,323.51€	13,754.39€
2.3.	Tatimet për paga dhe mëditje	1,193.66€	1,064.13€	1,463.33€	1,393.78€	5,114.90€
2.4.	Kontribute pensionale	1,464.90€	1,352.60€	1,702.50€	1,676.00€	6,196.00€
2.5.	Konferenca,Kuvendi dhe Faksimilat	3,052.80€	8,395.20€	9,033.15€	1,577.55€	22,058.70€
2.6.	Anëtarshimi në ERO	-	-	-	250.00€	250.00€
2.7.	Auditimi Financiar/Funksional 2020	-	-	-	2,500.00€	2,500.00€
2.8.	Participimi i OSK për Obelisk	-	-	5,569.33€	-	5,569.33
2.9.	Komunale (rrymë,ujë,mbeturina,ngrohje)	-	80.96€	93.38€	59.19€	233.53€
3.0.	Rilokimi në zyret e reja të OSK	1,632.49€	-	-	-	1,632.49€
3.1.	Qiraja dhe Tatimi në qira	795.40€	1,252.74€	1,252.74€	1,252.74€	4,553.62€
3.2.	Administrative/Operacionale të zyres: web,materiale të ndryshme pune për zyre	664.81€	1,337.90€	906.45€	2,544.60€	5,453.76€
3.3.	Reprezentacion për KD dhe komisione të përhershme, telefon	760.77€	583.38€	939.48€	801.49€	3,085.12€

	dhe internet, derivate, taxi)					
3.4.	Provizione bankare (kthime tjera)	133.80€	446.60€	294.00€	175.10€	1,049.50€
I. GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë kryesore të OSK-së:						113,837.21€

2 - SHPENZIMET NË LLOGARINË E FONDIT PËR SOLIDARITETET

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIM ET TM1:TM4
2.1.	Përkrahje financiare nga fondi për Solidaritet i OSK-së	-	-	-	1,200.00€	1,200.00€
2.2.	Provizione bankare	3.00€	3.00€	3.00€	3.00€	12.00€
II. GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë e fondit për Solidaritetit të OSK-së:						1,212.00€

Gjithsej Shpenzimet nga: Llogaria kryesore + Llogaria e Solidaritetit (I+II) **115,049.21 €**

1 – Llogaria kryesore bankare e OSK-së	2- Nënlllogaria e Fondit për Solidaritet
SALDO ME DATË: 01.04.2021.....75,386.88€	SALDO ME DATË: 01.04.2021.....4,490.11€
GJITHSEJ TË HYRAT..... 173,776.81€	GJITHSEJ TË HYRAT 2,506.80€
GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....249,163.69€	GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....6,996.91€
GJITHSEJ SHPENZIMET..... (113,837.21€)	GJITHSEJ SHPENZIMET..... (1,212.00€)
SALDO ME DATË 31.03.2022..... 135,326.48€	SALDO ME DATË:31.03.2022..... 5,784.91€

1-Gjithsej të hyrat.....	173,776.81€	1-Gjithsej të hyrat.....	2,506.80€
2-Gjithsej Shpenzimet.....	(113,837.21€)	2-Gjithsej Shpenzimet.....	(1,212.00€)
3-Bilanc pozitiv financiar.....	59,939.60€	3-Bilanc pozitiv financiar.....	1,294.80€

**RAPORTI NË MES TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR DY LLOGARITË
BANKARE PËR PERIUDHËN: 01.04.2021. – 31.03.2022.:**

1 - Të Hyrat gjithsej (1 + 1).....	176,283.61€
2 - Shpenzimet gjithsej (2 + 2)	(115,049.21€)
3 - Bilanc pozitiv financiar (3 + 3).....	61,234.40€

PLAN VEPRIMI I PUNËS PËR PERIUdhËN**prill 2022 – mars 2023**

Ky plan është përpiluar në bazë të objektivave të përcaktuara nga Kryetari dhe Këshilli Drejtues dhe të bazuara në programin për vitet 2019-2023.

Në këtë plan janë specifikuar aktivitetet kryesore:

1. Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënja për punën e Odës,
2. Vazhdimësia e publikimit dhe azhurimit të listës zyrtare të anëtarësisë dhe i publikimit të Regjistrit të licencave të stomatologëve,
3. Analizimi i akteve juridike të OSK-së mbi nevojën e plotësim ndryshimit të tyre,
4. Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK,
5. **Zhvillimi e sistemit informativ të OSK-së** (Sistem digjital për menaxhimin e aktivitetëve të ndryshme të cilat i ofron OSK-ja).
6. Organizimi i Konferencës vjetore stomatologjike,
7. Realizimi i programit të ligjeratave profesionale në 7 (shtatë) QKMF, në kuadër të EVP-së,
8. Botimi i dy numrave të Revistës së Stomatologëve të Kosovës,
9. Mbështetja e vazhdueshme ndaj anëtarëve të saj në të gjitha zhvillimet për avancimin e pozitës së stomatologut dhe prezantimit të interesave të tyre profesionale,
10. Organizimi i takimeve të rregullta “Ditët e hapura të Odës” dhe i tryezave profesionale me qëllim të identifikimit të problemeve, shqetësimeve të komunitetit tonë si dhe ngritjes së nivelit të tyre profesional,
11. Vazhdimësia për realizimin e projektit për ndërtimin e objektit të përbashkët të OPSH-ve,
12. Mbështetja financiare për anëtarët e Odës në rastet e sëmundjeve të rënda nga fondi i veçantë i solidaritetit dhe ndihmës reciproke,
13. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme vendore,
14. Bashkëpunimi ndërkombëtarë dhe rajonal,

15. Vazhdimësia e bashkëpunimit me FDI dhe European Regional Organization (ERO)
16. Auditimi financiar për vitin 2021.